


Në garën e 24 republikane pensioniste sportive më të mirët ishin garuesit nga SHP Tetovë, shoqatë me përbërje multietnike, e njohur mes pensionistëve me mundësitë e saja sportive nga vitet e mëparshme.

Edhe këtë vit, pensionistët për herën e 24, më 22 shtator në Radovish treguan që vitet nuk paraqesin kufij dhe që e dinë vlerën e sportit dhe aktivitetit fizik për njerëzit e gjeneratës së tretë. Olimpiada e 24 pensioniste e sportit, aktiviteti programues më i vjetër dhe më masiv në Lidhjen e shoqatave të pensionistëve të Maqedonisë, u mbajt me rastin dhe nderin e 20 shtatorit, Dita e pensionistëve në vendin tonë. Manifestimi ishte nën mbështetjen e Qeverisë dhe Ministrisë për punë dhe politikë sociale të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Festën e madhe pensionistëve ua uroi zëvendësministri për punë dhe politikë sociale, Gjoni Bajraktar, i cili me prezencën e tij e ngriti vlerën e këtij manifestimi sportiv të pensionistëve. Në manifestim, i cili për herë të pestë u mbajt në Radovish, organizator ishte LSHPM, ndërsa nikoqir Shoqata e pensionistëve nga Radovishi dhe Konçe. E para e cila ju drejtua të pranishmëve ishte kryetarja e Lidhjes, Stanka Trajkova, e cila mes tjerësh tha "Sot me të vërtetë mund të thuhet që për pensionistët të gjitha rrugët të çonin në drejtim të Radovishit, prandaj këtui, krahas pjesëmarrësve të drejtpërdrejtë, së bashku me vizituesit e tjerë dhe mysafirë shoqërohen

OLIMPIADA PENSIONISTE E SPORTIT "RADOVISH 2019"

PENSIONISTËT E TETOVËS FITUES NË OLIMPIADËN SPORTIVE



rreth 850 pensionistë, që është nderë për Lidhjen, për SHP Radovish dhe Konçe, por edhe për qytetin e Radovishit. Lojërata sportive pensioniste si ato rajonale edhe republikane, paraqesin ngjarje masive sportive, sepse në të janë përfshirë rreth 2.600 pensionistë nga të gjitha qytetet nikoqire. Gëzon fakti që këto aktivitete pothuajse gjithkund janë përkrahur nga vetë-qeverisja lokale". Pastaj të pranishmëve ju drejtua zëvendësministri për punë dhe politikë sociale, Gjoni Bajraktar i cili e theksoi kujdesin e Qeverisë dhe Ministrisë për punë dhe politikë sociale të Republikës së Maqedonisë së Veriut për jetë kualitative dhe dinjitoze të popullsisë më të madhe të cilën e përbëjnë personat e moshuar dhe shfrytëzuesit e pensionit.

"Lidhja e shoqatave të pensionistëve të Maqedonisë përfaqëson partner serioz të Qeverisë për realizimin e qëllimeve strategjike të

lidhura me avancimin e mbrojtjes dhe promovimit të të drejtave sociale dhe interesave të shfrytëzuesve të pensionit. Ministria për punë dhe politikë sociale vazhdimisht kujdeset për sigurimin e një jete dinjitoze të personave të moshuar dhe pensionistëve, përmes ndërmarrjen e masave për avancim të pozitës sociale dhe integritetit dhe përmirësimit të standardit të jetës të shfrytëzuesve të pensionit", u shpreh Bajraktar. Të pranishmëve ju drejtuan edhe kryetarët e Radovishit dhe Konçes, Gerasim Konzulov dhe Bllagoja Iliev, të cilët në përshëndetjet e tyre theksuan që në të ardhmen, ashtu si deri tani do t'i mbështesin aktivitetet e pensionistëve dhe që janë krenarë me bashkëqytetarët më të moshuar të tyre. Para se t'i shpallë Garat republikane pensioniste sportive të hapura, të pranishmit i përshëndeti edhe Mitko Stefanov, kryetari i SHP Radovish dhe Konçe.

"Kam nder dhe kënaqësi të veçantë, në emrin e SHP Radovish dhe Konçe, t'ju përshëndes dhe t'ju uroj një mirëseardhje të ngrohtë në qytetin, i cili këtë vit shënon 1000 vite nga përmendja e parë e Radovishit në ndonjë dokument të shkruar", u shpreh Stefanov.

Para fillimit të garave, sportistët i përshëndeti kryetari i Komisionit për sport dhe rekreacion në LSHPM, Zdravko Petkovski, i cili pjesëmarrësve ua shpjegoi rregullat më të rëndësishme rreth garës. Pastaj filloi gara e cila edhe këtë vit ishte në 11 disiplina, ndërsa morën pjesë 504 garues, pothuajse në mënyrë të barabartë në konkurrencën e femrave dhe meshkujve. Në garën e 24 republikane pensioniste sportive më të mirët ishin garuesit nga SHP Tetovë, shoqatë me përbërje multietnike, e njohur mes pensionistëve me mundësitë e saja sportive nga vitet e mëparshme. Tetovarët e fituan kupën fituese dhe kalimtare. SHP Tetovë, kupën e pranoi nga kryetarja e LSHPM, Stanka Trajkova, duke i uruar, ndërsa kupën e pranoi Selver Memeti kryetari i shoqatës, i cili i emocionuar nga zemra i falënderoi anëtarët e tij, por edhe LSHPM si organizator i këtij manifestimi të bukur, me urim për shëndetin, shoqërimin dhe bashkëjetesën e pensionistëve.

(Kalina S. Andonova)

AKTIVI I PENSIONISTEVE PRANË SHP SARAJ



Mbahet punëtori për punime dore

Në kuadër të Programit për punë, më 20 shtator të këtij viti, në klubin e Shoqatës së pensionistëve nga Komuna e Sarajit-Qendra ditore për qëndrim të personave të moshuar, Aktivi i pensionistëve pranë Shoqatës, në bashkëpunim me Kryqin e kuq, mbajti punëtori për përpunim të punimeve të dorës për fëmijë me material të dhuruar nga ana e Kryqit të kuq.

Prodhimet e punuara Kryqi i kuq, në nivel të qytetit dhe më gjerë do të organizojë pazar, ndërsa mjetet e fituara do të dhurohen për qëllime humanitare. Në këtë takim, pensionistja e artit Violeta Tortevska, ka realizuar më shumë vizatime dhe piktura me të cilat planifikon të hapet ekspozitë.

Përndryshe, Aktivi i pensionistëve pranë Shoqatës së pensionistëve të Komunës Saraj është formuar në vitin 2013, dhe nën udhëheqjen e udhëheqësisë në krye me Zulfije Ramadani, nga viti në vit arrin rezultate më të mira. Aktivi ka marrëdhënie të shkëlqyer me Kryqin e kuq, me të cilin së bashku e shfrytëzon lokalitetin edhe si Klub edhe si Qendër ditore për qëndrim të personave të moshuar, në të cilin çdo muaj së bashku bëjnë programe për aktivitetet të cilat realizohen gjatë muajit. Kontribut të shkëlqyer për shëndetin e pensionistëve japin edhe motrat medicinale të angazhuara nga ana e Kryqit të kuq. (B.B)

SHPDIBËR-QENDËRZHUPA

Një ditë pak më ndryshe për pensionistet nga Dibra

Anëtarët e shoqatës së pensionistëve Dibër-Qendra Zhupë vizituan qytetin e Pogradecit. Gjatë ditës, ata kanë shëtitur nëpër brigjet e Liqenit të bukur të Ohrit dhe nëpër Pogradec. "Në shoqërimin e përbashkët ata realizuan një ditë të bukur aq të nevojshme për këtë moshë. Kjo ditë ishte e liruar nga monotonia e përditshme. Mirë është që një herë në muaj të dilet nga shtëpia dhe të jesh në shoqëri me bashkëmoshatarët",



thotë Imjan Shemsu, një nga organizatorët e kësaj shëtitje.

Edhe pensionistët tjerë kanë të njëjtin mendim. Ata thonë se kur kanë qenë të ri, kanë punuar

shumë, të paktën tani duhet të shëtisin. Shtojnë që nga kjo shëtitje kanë marrë shumë kujtime të bukura. Në shoqërinë e kompanisë për transport të udhëtarëve

"Unik Turs", pensionistët nga Dibra vizituan edhe disa nga periferitë e qytetit të bukur të Pogradecit. Shëtitjet dhe udhëtimi ishte i shoqëruar me këndim, qeshje dhe fotografi nga pushimi dhe zbavitja që ata e meritojnë.

Në mbrëmje, janë kthyer në Dibër me shpresë që së shpejti do të organizojnë edhe një shëtitje, e cila do t'i pasurojë ditët e tyre pensioniste me gëzim dhe përmbajtje të reja. (Vjollca Sadiku)

SHPCAIR

Ekskursion në Shqipëri

Rreth njëqind pensionistë nga SHP Çair, me përbërje multietnike, përmes kalimit kufitar Qafëthanë, më 26 shtator 2019, ishin në ekskursion njëditor në qytetin e Korçës. Gjatë rrugës kanë patur pauzë për pushim, ndërsa në hyrje të Shqipërisë, tek vendi Lin, pensionistët kanë pushuar, duke u mahnitur me bukuritë natyrore të pamjes së bukur të Liqenit të Ohrit.

Pastaj kanë vazhduar drejt qytetit të Korçës, një nga qendrat më të vjetra kulturore-historike dhe më i madhi në Shqipërinë juglindore, ku kanë patur mjaft kohë të lirë për pushim dhe shëtitje, si dhe vizitë dhe shëtitje të më shumë atraksioneve. Disa nga pensionistët e kanë vizituar shkollën e parë në gjuhën shqipe të datuar nga viti 1887, prej ku ka filluar alfabeti shqip, ndërsa

tani është muze. Tjerët pensionistë, kanë ecur dhe shëtitur nëpër shëtitoren e gjerë dhe të gjatë, e kanë vizituar Kishën e madhe "Ringjallja e Krishtit", e ndërtuar në kohët e fundit, e ndërtuar në brendësi me gdhendje dhe afresk të shkruar në gjuhën greke dhe shqipe, e cila i ka mahnitur me ndërtimin e bukur të saj. Shumica e pensionistëve kanë qenë në pjesën e vjetër të qytetit,



ku kalldërma nëpër rrugët dhe trotualet ka qenë karakteristikë e kësaj pjese të qytetit, e pasur me kafene. Të kënaqur nga ajo që kanë parë

dhe ndërë nga ky qytet, pensionistët nga SHP Çair e kanë përmbledhur udhëtimin e tyre me qindra fotografi. (Vasil Paçemski)